



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit



01 Nr 020/04-29616 dt. 02.07. 2021

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 17 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nenin 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit Ad Hoc për Shqyrtimin e Ankesës Nr.01-070/01-28732, të datës 29.06.2021

I. Formohet Komisioni Ad Hoc për Shqyrtimin e Ankesës Nr.01-070/01-28732, të datës 29.06.2021, në këtë përbërje:

1. Gentianë Morina, (kryetar),
2. Altina Mulaj, (anëtar),
3. Liridona Durshmi, (anëtar).

II. Komisioni është përgjegjës që të shqyrtojë ankesën Nr.01-070/01-28732, të datës 29.06.2021.

III. Gjatë shqyrtimit të ankesës se lartcekur komisioni është i obliguar që të hartojë procesverbal dhe të marrë vendim për miratimin apo refuzimin e saj në afatin e paraparë sipas dispozitave ligjore.

IV. Ky komisioni bazë për punën e tij duhet të ketë: Ligjin Nr.04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, Ligjin Nr.04.L-110 për Ndërtim. Udhëzimin Administrativ Nr.05/2017 për Mbikëqyrjen Inspektuese dhe Procedurën për

Lëshimin e Certifikatës së Përdorimit, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

V. Komisioni i formuar sipas pikës I (një) të këtij Vendimi vlen vetëm për shqyrtimin e ankesës Nr.01-070/01-28732, të datës 29.06.2021.

VII. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.

VIII. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Anëtareve të Komisionit;
- Arkivit të Komunës së Drenasit.


Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci